



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2941/2 prot

Datë 24.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ‘Ylli Myteveli’ Pf në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” me nr REF-82257-10-04-2023 me objekt “**Materiale per ngrohje dru zjarri**” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf nr NIPT L64506003C
Lagjja 17, Rruga Marigo Pozio, Zona kadastrale 8564, Nr.pasurie 8/218, Korce

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq
Bulevardi “Rinia”

Në datën 23.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3643 dhe me nr. 2941/2023 prot., datë 23.11.2023 e operatorit ekonomik ‘Ylli Myteveli’ Pf për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” me nr REF-82257-10-04-2023 me objekt “Materiale per ngrohje dru zjarri” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 17-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “Ylli Myteveli” Pf.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Ylli Myteveli” Pf në ankesën nr. 2941 datë 23.11.2023, pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit përkatësisht Pika 2.3.2. Subjekti duhet të vërtetojë se ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor , shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohe në DST. Ose Të ketë kontratë furnizimi me një subjekt që ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor e shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të materialit drusor që mundëson furnizimin me dru zjari për sasinë që prokurohet. Ose ne rastin e subjekteve te cilet jane tregtues te mallit (objekt prokurimi), nepermjet importit ,duke vertetuar me faturat doganore ose te kene kontrate furnizimi me subjekte te tjera qe importojne mallin objekt prokurimi • Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “Ylli Myteveli” P.F nuk përmbush pikën 2.3.2 të kërkuar ,konkretisht Sasia e kërkuar e druve sipas DST është 1445,5 mst . Operatori Ekonomik ka paraqitur lejën e shfrytëzimit të lëndës drusore ku verteton sasinë e prokuruar 1539m3 e cila është më pak se ajo e kërkuar në DST. ”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 24.11.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri